

VENDIM
Nr. 137, datë 12.3.2014

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 3, e 75 të ligjit nr. 9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përgjashtimisht për vitin 2014, lejohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit të realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve elektronike. Në procedurat e prokurimit përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama